



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-27138/23
Kaçanik, 17.10.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e IX (nëntë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 25 tetor 2023 (e Mërkurë), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e IX (nëntë) të Rregullt të KPF-s të datës 25.10.2023, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2023;
3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
5. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, pronën komunale, kompanisë së Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike -KEDS, për vendosjen e trafostacioneve;
6. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Sponicë;
7. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
8. Informatë e drejtorisë së Arsimit për fillimin e Vitit të Ri Shkollor 2023/2024;
9. Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e Vitit Shkollor 2022/2023.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-24305/23
Kaçanik, 22.09.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (tetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 22 shtator 2023. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF fillimisht ishin 6 anëtarë, Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi, ndërkohë gjatë shqyrtimit të pikës së dytë, arriti edhe Fitore Vishi, kështu që konstatohet se ishin 7 anëtarët- të gjithë.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Ramadush Osmani-DSHPE, Dardana Tafili Dauti -DAP.

Mbledhjen e monitoroj Faruk Dërmaku-OSBE.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu- Zyrtares për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të KPF-a për vitin 2023, data 22 shtator, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026;
3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
5. Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e anëtarëve të KK, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi;
6. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023;
7. Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit profesional të komunës, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshrit të datës 23.07.2023 në territorin e Komunës së Kaçanikut, në fshatin Biçec;
8. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër, në ZK Kaçanik;
9. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;
10. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00153-24 të Ramiz Shaqiri, për këmbim me pronën komunale 01908-15, në ZK Kaçanik;
11. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00643-0 të Adnan Vishi, për këmbim me pronën komunale 00644-1, në ZK Kaçanik;
12. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00544-0 të Mejdi Xhokli, për këmbim me pronën komunale 00545-0, në ZK Koxhaj.

Lidhur me rendin e propozuar të punës, e hapi diskutim:

z. Agim Mani: Meqë rendi i punës është i ngarkuar, e kemi edhe buxhetin në shqyrtim të kësaj mbledhje, kështu disa pikë të rendit të punës ka pasur mundësi të shtyhen për mbledhjen vijuese, si çështja e këmbimit të pronave, këto çështje nuk janë urgjente.

Të çështja e materialeve të KK, ka pasur probleme në dërgim të materialit, bisedova edhe me zyrtaren e KK, nuk e di a e ka marrë ndokush materialin, ndërkaq ne si grup parlamentar i LVV dhe e kemi marrë pjesën e parë për mbledhje të KK, ndërsa sot pjesën e dytë. Nëse i marrim parasysh afatet ligjore, në këtë drejtim jemi të vonuar. Është mirë me iu përmbajtur afateve ligjore, që t'kemi hapësirë me u përgatitur për pikët.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë të nevojshme me u kryer edhe çështja e këmbimeve, se tani në qytet është duke u rregulluar sheshi, rrugët. Të çështja e materialeve, ka qenë një defekt e emailit të zyrtares së KK, tani janë dërguar përmes emailit të asistentes, Mavije Murseli, besoj se iu kanë ardhur materiali. Kjo nuk është bërë me ndonjë qëllim se zyrtarja e KK është shumë e përgjegjshme, por çështja është e defekteve teknike.

Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 12 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri me një korigjim teknik. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VII (shtatë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023 të datës 25.07.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-17436/23.

2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026;

Kryesuesi i Kuvendit: Buxheti për vitin 2024 dhe vlerësimet për dy vitet vijuese, është hartuar nga DBF, drafti ka kaluar procedurat e dëgjimeve buxhetore të organizuara nga ekzekutivi edhe nga KK dhe i njëjti është proceduar në KK në afatin e përcaktuar ligjor. Për sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i Buxhetit dhe Financave, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi-DBF: Materialin e keni marrë ju të KPF, buxheti është si është projektuar me një ndryshim të lista e projekteve kapitale, të numri rendor 53, të projekti furnizimi i shkollave me pajime dhe mobilje është bërë: “Ndërtimi i kulmit të SHFMU “ Agim Bajrami” Stagovë, se ministria kërkon me i specifikuar projektet. Në disa dëgjime publike ka qenë kështu, në ndërkohë është ndryshuar. Buxheti i projektuar i vitit 2024 është 11,958,983.00 €, kemi ngritje për 12.03%. në masë monetare 1, 284,294.00€, e cila rritje shkon në paga dhe mëditje për shkak të ndryshimit të Ligjit të pagave. Shpërndarja buxhetore është si vijon: Paga dhe Mëditje, 6,759,179€, Mallra dhe Shërbime, 1,421,513€, apo 74,000 me pak se ky vit, Shërbime Komunale, 200,000€, Subvencione dhe Transfere, 415,529€, për 25,000€ se vitin e kaluar, Investime Kapitale (IK) 3,162,761€, kemi ngritur IK për 191, 448 €. E potencoj edhe kryesuesi për dëgjime publike me qytetarë, OJQ dhe grupe tjera të interesit, se janë shterë të gjitha diskutimet për buxhetin.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Përveç kodeve të reja, e kuptojmë pse i bëni, e kam një pyetje, të DA, kodi 51, flitet për ndërtimin e SHFMU “ Emin Duraku”, kod ky i bartur vit pas viti, për vitin 2024 janë paraparë 50,500€. A mundeni me na sqaruar se a është realizuar projekti, a janë gjetur mjetet apo vetëm ka me vazhduar avazi i vjetër. Për dallim nga viteve tjera që është ndarë shumë 5,000€ në këtë kod buxhetor, këtë herë është një kosto e mjeteve e ndarë, se kam marrë pjesë në debatin publik të fundit, debati është për qytetarë, ndërkaq unë kam marrë pjesë dhe i kemi paraqitur kërkesat e mia, por nuk janë bërë ndryshime. Kur nuk kam marrë pjesë në debat, ju keni qenë ai që me keni kritikuar që nuk kam marrë pjesë dhe me keni thënë, qysh po prisni me t’u realizuar kërkesat, kur nuk keni marrë pjesë në debat publik. Kërkoj me ditur për ne si opozitë, ku duhet me i adresuar kërkesat tona? Kërkesat e mia kanë qenë: 1. Në rrugën “Malsor Dashi” pjesa që lidhë Dushkajën me f. Stagovë konkretisht deri varrezat e reja të qytetit, me u bërë trotuari dhe ndriçim publik. 2. Të ndahet një buxhet për Grupin jo formal të grave asambleiste. 3. Shtimi i shtretërve në Çerdhen publike në Kaçanik.

Kryesuesi i Kuvendit: Për buxhetin e kërkuar për Grupin e grave asambleiste, mundemi të kodi i Mallrave dhe Shërbimeve me i shtuar edhe 1,000€ nga Mallrat dhe Shërbimet e Ekzekutivit. E bëjmë propozimin në KK ose këtu.

z. Bahri Selimi: Unë qëllimisht kërkoja me i përmendur kërkesat e juaja. Ne i kemi pasur parasysh kërkesat e juaja. Çështja e shtretërve në çerdhe, mundet me u realizuar nga mallrat dhe shërbimet. Kërkesa të rruga “ Malsor Dashi” është kërkesë me vend, por në rrugët lokale dhe ato urbane i kemi lënë disa kode të përbashkëta, pastaj Kryetari me ekzekutivin i shikojnë kërkesat me prioritet me i realizuar. Aty sa e di unë ka probleme të shpronësimeve, se përndryshe mundemi edhe tani me intervenuar. Shkolla “Emin Duraku” është shqetësimi kryesor, ndërtimin e shkollave fillore e ka në kompetencë ministria se kjo është në përgjegjësi të ministrisë. Çështja është e vlerësimit se a duhet të bëhet shkolla e re, komuna nuk ka mundësi me ndërtuar shkollë të re të madhe, ndërsa ndonjë shkollë të vogël dhe ndonjë rehabilitim komuna mundet me bërë. Ne i kemi anuluar disa kode tjera dhe kemi ardhur të kjo shumë. Alternativë tjetër me u rritur kjo shumë është: Ne jemi në pritje të MKRS, për parkingun nëntokësor, nëse përgjigja na vjen negative, ne kemi me u munduar me rritur buxhetin për këtë shkollë, por edhe nëse e rrisim buxhetin, nuk mundemi mbi 300,000€, kështu nuk mund të ndërtohet shkolla pa investuar ministria, jemi duke bërë përpjekje në këtë drejtim, se kushtet në atë shkollë janë në gjendje të mjerueshme.

z. Agim Mani: Çështja e buxhetit nga dëgjimet publike të Ekzekutivit dhe e Kryesuesit të KK, rrugës ka pësuar ndryshime, atë që e potencoj edhe drejtori në fillim, unë e kam pa një ndryshim në të njëjtin kod, iu ka ndërruar emri, konkretisht projektit: Renovimi i kulmit të shkollës në f. Stagovë, në dëgjim publik ka qenë, ndërkaq kur na keni dërguar materialin, ka marrë emër për mirëmbajtje dhe pajisje. Unë u konsultova me drejtorin, me tha kjo është punë e kryer, ndërkaq unë në buxhet nuk e pashë këtë projekt. Pyetje për drejtorin për renditjen e tabelave 4.1 të Zyra e kryeartit, është bërë ndarja e të hyrave vetanake, dhe të 1.1 është e njëjta shumë është dhënë me kod dhe pa kod, është përshkruar dy herë shuma është 343,263€. Cilat janë projektet e ndryshme infrastrukturore me këtë buxhet, për të cilat për tre vite kanë me u realizuar, se nuk dimë ne çka votojmë, cilat rrugë kanë me u shtruar.

z. Bahri Selimi: Ka mundësi ua dërgojmë edhe një herë materialin me ndryshime, edhe me këtë projekt. Të plani i ndarjeve buxhetore, e njëjta shumë shënohet në program dhe bartet të nën programi. KK nuk ka nën program. T’i sqaroj edhe në zyre me në detaje. Të shpenzimet infrastrukturore, janë për rrugë urbane dhe rrugë rurale sipas prioriteteve se ka shumë rrugica, në vitin e kaluar kanë qenë bashkë, as vet nuk e dimë saktë se cilat rrugë kanë me u shtruar. Duke i pa emergjencat, problemet pronësore, DUKMM i ka me në kompetencë, para se me u bërë tenderi, bëhet një vendim i ndajnë mjetet se ku i orientojnë.

Kryesuesi i Kuvendit: Ndryshime mundemi me i bërë edhe aty për aty në mbledhje.

z. Kadri Krivenjeva: Kërkesat e kolegëve të mi janë shumë me vend, se ne për atë jemi këtu. Kam vërejtje në buxhet, se në komunitetin Krivenjevë nuk është investuar asnjë projekt, edhe pse është i shkatërruar nga lufta tërësisht, sepse të paktën një rrugë ky komunitet e meriton, por që 24 vjet nuk është bërë asgjë që me i motivuar qytetarët për atë vend. Unë nuk kam diçka tjetër dhe jam kundër këtij buxheti. Unë do të kërkoj edhe mbështetjen e kolegëve të mi, pozitivë dhe opozitë, përndryshe unë nuk do të votoj këtë buxhet.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026. Ky propozim vendim, i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi: Rialokimi ka të bëjë me mjetet për projektin e ndërtimit të parkingut nëntokësor të komunës. Kryetari është duke pritur një përgjigje sot nga MKRS, për shkak të mureve arkeologjike. Kontrata për parking është lidhur, nëse nuk na lejojnë, atëherë këto mjet rialokohen në projekte tjera. Nëse lejohet me u kryer parkingu, atëherë për KK ne e tërheqim këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Këto mjet rialokohen për sistemin e ngrohjes së administratës komunale. A nuk keni të drejtë me i bartë diku tjetër, se në vitin tjetër përsëri kemi me i transferuar.

z. Bahri Selimi: Rialokimi bëhet brenda drejtorisë, 100,000€ kanë qenë, 10,000€ janë shpenzuar, është arsyeimi i drejtorisë, këto mjet janë grant qeveritar, duhet me i shpenzuar që mos me u kthyer prapa. Mundem vetëm 15% të shumës me i bartë diku tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Rialokimi është diçka tjetër, ndërkaq transferi është diçka tjetër. Diskutime të tjera, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023. Ky propozim vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi: Të DSHPE kanë shumë projekte që kanë mbetje, kështu ka kërkuar që mjetet e ngelura nga 3 projekte 34,003€ ka kërkuar me ia dërguar të mallrat dhe shërbimet se ka mungesë të mjeteve, sidomos të mirëmbajtja e rrugëve. E quajnë transfer, sepse e kalon njësinë, nga Investimet Kapitale në Mallra dhe Shërbime. Arsyeimi është bërë nga DSHPE.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ju me herët e thatë se nuk ka të drejtë me i rialokuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Të rialokimi jo, ndërkaq të transferet po.

z. Ramadush Osmani: Të projekti i rialokimit të mjeteve të parkingut, munden me u rialokua në mallra dhe shërbime, por nuk i nevojiten drejtorisë mjetet në këtë program shpenzues buxhetor.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023. Ky propozim vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e anëtarëve të KK, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi;

Kryesuesi i Kuvendit: Ne çdo vit kemi realizuar vizita të tilla. Nuk e kemi caktuar ende se ku do të bëjmë vizita, por në bashkëpunim me Shefat e GP, ne do të shkojmë me procedura të tenderit si çdo vjet, se nuk kemi pasur problem as me auditim. Mendimi im është me shkuar në pjesën veriore, megjithatë e diskutojmë përsëri, mjete nuk kemi për me larg. Mirë është me qenë pjesëmarrja me e madhe, do të caktojmë edhe ditët sa do të qëndrojmë. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Vizitat në Mal; të Zi, a kemi me i realizuar në komunat shqiptare dhe cilat janë datat e vizitës ?

Kryesuesi i Kuvendit: Ne mendojmë me realizuar vizita në Shkodër dhe në Ulqinin, por duhet të vëmë kontakte, se ka procedura të tenderimit. Vizita do të bëhet diku kah gjysma e muajit nëntor. Diskutime të tjera, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e anëtarëve të KK, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi. Ky propozim vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Kryetari është prezent në mbledhje, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që raportin t'ia adresojmë KK. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se **Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë shqyrtimi.**

7. Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit profesional të komunës, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshrit të datës 23.07.2023 në territorin e Komunës së Kaçanikut, në fshatin Biçec;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtorja e ka sjellë një komision profesional për vlerësimin e dëmeve nga breshëri. E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: A ka pas edhe ankesa tjera, a ka pasur thirrje publike për qytetarë se kush ka pasur dëme, apo ka qenë vetëm kërkesa e një individi? Komisioni i formuar nuk kishte kuotë gjinore. A paraqet kjo problem mos përfaqësimi gjinor në këtë komision?

z. Suhad Dullovi: Kërkesa ka qenë e fermerëve për dëmin që iu ka shkaktuar nga të reshurat breshëri. Komisioni ka dalë në terren dhe i ka vlerësuar dëmin dhe i vetmi person që i ka plotësuar kriteret dhe ka bërë kërkesë edhe në ministri, ka qenë ky zotëria. Kërkesa e drejtorisë tonë ka qenë në ministrinë e Bujqësisë për demet e shkaktuara, por kompetencat i ka marrë Agjencia Emergjencave, për këtë arsye është vonuar kërkesa se ka pas me u bërë me herët. Ka pasur edhe kërkesa tjera për sera, por ministria nuk i ka marrë për bazë, pasi që i merr për bazë vetëm ato që janë mbi 5 ari. Komisioni ka qenë me herët prej 3 anëtarëve nga Agjencia e emergjencave, tani është sjellë vendimi që komisioni me qenë prej 5 anëtarëve dhe është formuar ky komision. Komisioni është profesional dhe për shkak të vizitës në terren nuk ka përfaqësim të femrave.

Kryesuesi i Kuvendit: Vetëm te ne po e shikojnë përfaqësimin gjinor, se nuk po i shikojnë as në qeveri e as në komisionet parlamentare.

z. Agim Mani: Kur është formuar ky komision?

z. Suhad Dullovi: Komisioni është formuar nga DBPZHR, fillimisht ka qenë prej 3 anëtarëve, ndërkaq me kërkesën e Agjencisë për Emergjencë, komisionit iu kanë shtuar edhe 2 anëtarë, se e kishin një rregullore që përcaktonte numrin prej 5 anëtarëve të komisionit. Me herët i kemi dërguar drejt në ministri, nuk ka pasur nevojë për procedurë të KK, tani me procedurë të KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit profesional të komunës, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshrit të datës 23.07.2023 në territorin e Komunës së Kaçanikut, në fshatin Biçec. Ky Propozim Vendim i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

8. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër, në ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Këtë çështje e patëm edhe me herët në mbledhje të KK, dhe MAPL ka kërkuar me i ndarë vendimet. Ne në mbledhjen e kaluar, vendosëm për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale, ndërkaq tani e kemi vendimin për afatshkurtër. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kërkoj sqarim për parcelat që do të epën në shfrytëzim. A është i paraparë me PZHK dhe a keni menduar fillimisht me ia ndërruar destinimin pronës. Nëse e procedon me ankand publik, mundet me u bërë fushë sporti ajo pjesë, por nuk të lejon plani, për atë destinimin duhet me ia përcaktuar në kohë.

z. Qamil Stagova: Është në PK Nr. 00005-2 ZK Kaçanik, në vendin e quajtur “ Seperacija” të Tregu i kafshëve, një pjesë e saj epët në shfrytëzim se ajo pjesë është e gjatë dhe shkruan pjesë e degraduar e lumit. Procedura shkon përmes Ankandit publik.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk mundemi me dhënë në shfrytëzim në kundërshtim me PZHK. Dhënia është në afatshkurtër. Me herët e kemi dhënë atë pronë për treg të kafshëve, por nuk ka funksionuar. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajjtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër, në ZK Kaçanik. Ky propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

9. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajjtshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe të ky propozim vendim, formohet një komision për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ky komision ka me vlerësuar vetëm dhënien në shfrytëzim afatshkurtër komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: Po, ky komision vlerëson vetëm dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale. Sipas ligjit komisioni formohet vetëm për pronat e parapara me një vendim paraprak. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajjtshme të komunës. Ky propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

10. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00153-24 të Ramiz Shaqiri, për këmbim me pronën komunale 01908-15, në ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori i DUKMM, Qamil Stagova është prezentë në mbledhje, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Unë i pashë tre propozim vendimet e kësaj natyre, me intereson të di pse këmbimi diku bëhet 1:1 e dikujt 2:1. Nuk kam asgjë personale me pronarët e këtyre pronave, por me intereson me çfarë kriteri bëhet raporti i këmbimit.

z. Qamil Stagova: Të çështja e pronës së Ramiz Shaqiri, prona është në rrugën: “Emsale Frangu” të shkolla të KISI, aty në njërën anë ka edhe pronë të komunës, ka edhe shtëpi të ndërtuara, ne kemi marrë pjesën tonë ku kemi munduar, kurse në anën tjetër, prona shkon në drejtim të rrugës, pronarët kanë pronë të vetën në rrugë, terreni nuk na i mundëson shumë me u barazua për këmbimin, se është pronë e komunës, por e ka shtëpinë aty. Ne në shtëpia nuk kemi prekur në asnjë rast. Besoj se bëhet një zgjerim i mirë aty me këtë këmbim.

znj. Ardita Rrahmani: Pyetje, Ramiz Shaqiri a ka pronë të vetën edhe përballë rrugës, se për në njërën anë e di.

z. Qamil Stagova: Po, Ramiz Shaqiri ka pronë përballë aty.

z. Agim Mani: Unë kam paqartësi, se pjesa që merret, shihet se e pengon rrugën, edhe pse merret dyfishi i saj. Të kufijtë kadastral të sipërfaqja, shënohet sipërfaqja e cila propozohet nga pronari, është 42.41 m², pronë kjo komunale. Kjo është shënuar të skica. Me intereson të di, a është me i madh interesi i komunës apo i pronarit. Në bazë të sipërfaqeve të propozuara me u këmbyer, shihet se interesi është personal.

z. Qamil Stagova: Këmbimi bëhet në dy anët e rrugës, këmbimi bëhet me pronën private, me pjesën parcelës kadastrale 00 153-24, 27.47 m² me pronën e komunës me pjesën e parcelës kadastrale 01909-15 me sipërfaqe 42.41m².

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtor shikoni nëse në skicë mos është gabim, se pala ka dalë në rrugë, ndërkaq komuna në një pjesë që nuk na duhet fare, pasi që kufijtë e rrugës janë drejt. Pasi e ka shtëpinë këtu në rrugë, t'i japim me pak pronë në këmbim, e jo e kundërta, se ky është fajtor e jo komuna.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi; Ai e ka shtëpinë aty, për mos me ia hequr shtëpinë e kemi bërë një tërheqje-para hyrje, shihet pjesa si në kënd, pak e devijuar.

z. Qamil Stagova: Me letra prona është midis rrugës, rruga është duke u zgjeruar.

znj. Ardita Rrahmani: Ne e frekuentojmë disa herë në ditë atë rrugë. Në atë rrugë shumica janë në pronë të shtetit. Unë nuk jam me ia prishur shtëpinë askujt, por këtu po krijohet një praktikë e keqe për të ardhmen, për me ndërtuar shtëpi në pronë të shtetit, me shpresë se nuk do të prishën.

z. Qamil Stagova: Sqaroj për pjesën e shtëpive në atë rrugë të cilat janë në pronë të shtetit, ndërsa për pjesën që po flasim është pronë private e cila është në rrugë. Aty ka shtëpi të ndërtuara paralufte dhe paslufte.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00153-24 të Ramiz Shaqiri, për këmbim me pronën komunale 01908-15, në ZK Kaçanik.

Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

11. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00643-0 të Adnan Vishi, për këmbim me pronën komunale 00644-1, në ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, është një ndryshim i cili është shpërndarë në mbledhje material. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Në bazë të skicës, shihet se prona është e shtetit që kërkohet me u këmbyer.

z. Qamil Stagova: Këta e kanë një lëndë gjykatë dhe në bazë të marrëveshjes e kanë tërhequr padinë nga gjykata, se ata pretendojnë se prona është e tyre. Ne kemi arritur një marrëveshje, ashtu që pjesën që e merr komuna është me interes se është me afër rrugës, sesa pjesa prapa e cila i epet në këmbim palës.

z. Ramadush Osmani: Ai pretendon me marrë krejt pronën, ndërkaq me këtë këmbim, zgjidhet një problem i kësaj çështje.

z. Agim Mani: Kërkoj sqarim për raportin e pronave që këmben. Unë po e lexoj të arsyetimi: Ky këmbim është me interes të përgjithshëm, dhe të Adnan Vishi. Me këtë këmbim do të

krijohen mundësitë e rregullimit të hapësirës pran sheshit të qytetit, i cili është në pronën e çerdhes së fëmijëve dhe pran rrugës “Sali Bajra”. Po ashtu pas aprovimit të këtij vendimi, z. Vishi do të tërheq lëndën lidhur me këtë pronë, e cila është në shqyrtim gjyqësor, se kjo lëndë është çështje kontestuese.

Kryetari i Komunës: 56m2 i jep pala, ndërkaq i merr 59m2.

Kryesuesi i Kuvendit: Prona që këmbëhet me të komunës është e palës, por ai pretendon që edhe pjesa tjetër është e tij. Këmbimi nuk mund të bëhet nëse pronari nuk ka pronë.

z. Qamil Stagova: Pala e ka bërë padinë për pronën e komunës, se mendon që është e tij.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Pala për pronën që ka pretenduar që është e tij, ka bërë padi në gjykatë, tani e ka tërhequr padinë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00643-0 të Adnan Vishi, për këmbim me pronën komunale 00644-1, në ZK Kaçanik. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

12. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00544-0 të Mejdi Xhokli, për këmbim me pronën komunale 00545-0, në ZK Koxhaj;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi Diskutimin:

z. Agim Mani: Nëse një rrugë është me përmasa të njëjta, dhe e zgjerojmë vetëm një pjesë, cili është kuptimi i këtij këmbimi?

Kryesuesi i Kuvendit: Të kjo rrugë është një ngushticë e madhe, ky e ka respektuar vijën zyrtare, edhe në kadastër rruga me poshtë dhe me lartë është me e gjerë. Të shtëpia e Mejdiut rruga është pak më ngushtë, kjo mund të shihet edhe në skicë. Ai e ka pas ndërtuar edhe murin në pronën e vet, por për shikim se duket si me qenë në asfalt. Kjo pjesë ka arsye me u zgjeruar, ndërkaq prona që i epët është mal e bërlllok.

z. Qamil Stagova: Ky këmbim është dashur me u realizuar me herët, por ai tokën e kishte pasur në hipotekë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00544-0 të Mejdi Xhokli, për këmbim me pronën komunale 00545-0, në ZK Koxhaj. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:00. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët - 07.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 27.09.2023 në ora 11:00.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01-Nr. 400/03-27125/23
Kaçanik; 16.10.2023

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit nr.(Nr.08/L-193) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, te nenit 61 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, propozon KPF-së, këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR RIALOKIMIN E MJETEVE BUXHETORE SIPAS BUXHETIT TË VITIT 2023

1. Rialokimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (fondi 10):
Nga nën-programi Administrata dhe Personeli (16328), kodi funksional 0133:

Nga projekti me kod 50995 “Ndertimi i parkingut nentokësorë për Administratës komunale” shuma prej 89,662.00€;

Këto mjete rialokohen në kategorinë ekonomike **Investime Kapitlae** (fondi 10) në nën-programin Administrata dhe Personeli (16328), kodi funksional 0133, në projektin me kod 52636 “Rregullimi i sistemit të ngrohjes qendrore të objektit të Administratës Komunale, shuma prej 89,662.00€.

2. Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

Bashkëngjitur Propozim vendimit:

-Tabela e fletëtransfereve si dhe

-Vendimi Nr.132/2023 i datës 12.10.2023 nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve

Kryetari i Komunës:
Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministrarsivo za Financije - Ministry of Finance
Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Department

KËRKESA PËR RIALOKIM

PJESA 1: TË DHENAT E RIALOKIMIT

Emri i organizatës buxhetore		Kodi	
Emri i nën-programit	Administrata dhe Personeli	Kodi	16328

Kodi organizativ	Kodi i nën-programit	Kodi funksional	Burimet e Financimit	Emërtimi i Projektet	Kodi i projektit	Kategoria shpenzim eve	Aprovimi i tanishëm	Shuma e ndryshimit	Aprovimi i ri	Buxheti Aprovuar/Rishikuar	Totali i shumës së transferuar/ri lokuar	% Transferit/ Rialokimit (i ri ndaj buxhetit)
652	16328	0133	10	Ndërtimi i parkingut nentokësorë për Administratës komunale	50995	30	100,000.00	(89,662.75)	10,337.25	10,337.25	(89,662.75)	
652	16328	0133	10	Rregullimi i sistemit të ngrohjes qendrore të objektit të Administratës Komunale	52636	30	-	89,662.75	89,662.75	89,662.75	89,662.75	
							100,000.00	-	100,000.00	100,000.00	-	

PJESA 2: ALOKIMI I NDARJES BUXHETORE TË RIALOKUARA

(Shëno Po ose Jo)	Rialokimi të pasqyrohet në ndryshimet e alokimeve	PO	JO		
	Konfirmo që është dhënë plani i rishikuar i rrjedhës së pasqurës?	PO			

PJESA 3: ARSYETIMI (Të plotësohet nga organizata buxhetore)

Arsyeja e këtij rialokimi të mjeteve është pasi që gjatë gjurmimit të kompanis kontraktuese janë zbuluar bazamente të mureve të vjetra e të cilat po humbtohen dhe vlerohen nga komisioni i krijuar nga MKRS, dhe si shpejt po presim të marrim vendimin përfundimtar nga MKRS.

ORGANIZATA BUXHETORE CERTIFIKON QË KËRKESA ESHTË KONSISTENTE ME LIGJIN E BUXHETIT DHE PËRFAQËSON PËRDORIM EFEKTIV DHE EFIKAS
TË FONDEVE, KONSISTENT ME OBJEKTIVAT BUXHETORE TË ORGANIZATËS

Zyrtari kryesor financiar	Data	Zyrtari Kryesor Administrativ / Kryeshefi Ekzekutiv	Data
Valdrin Dogani	16.10.2023	Besim Ilazi	16.10.2023

ANALIZA E MF (Të plotësohet nga analisti i buxhetit)

PJESA 4: ANALIZA DHE APROVIMI

KËRKËNDRYSHIMET NË NDARJE BUXHETORE		NDARJA BUXHETORE KD E REGJISTRUAR NË SIMFK NGA*	
Drejtori i Buxhetit	Data	Departamenti i buxhetit regjistrimi i të dhënave*	Data
Salvador Elmazi			
		NUMRAT E KD	

Vrejtje:

*Kolona e hijezuar paraqet totalin e ndarjes buxhetore për kategorinë e shpenzimeve të nën-programit



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE
INSTITUT KOSOVA ZA ZAŠTITU SPOMENIKA
THE KOSOVO INSTITUTE FOR CULTURAL MONUMENT PROTECTION
No. 732, dt. 12.10.2023
PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za Zaštitu Spomenika

Nr. 132/2023
Datë: 12.10.2023

Rrezarta Loxha-Vitaku në cilësinë e zëvendësimit të Drejtorit të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, bazuar në Nenin 3, 4 dhe 6 të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, Nenit 5 (paragrafi 2 dhe 3) Nenit 6 (paragrafi 1 dhe 2), Nenit 8 (paragrafi 1, 2, 3, dhe 6) Nenit 10 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, 1.7, 1.15, 1.16, 1.17) të Rregullores Nr. 06/2017 për Caktimin e Institucioneve Publike të Trashëgimisë Kulturore, Vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e Institucioneve Kompetente, bazuar në Rregulloren Nr. 01/2023 për Hartimin e Projekteve të Konservimit/Restaurimit dhe Aktiviteteve Konservuese të Trashëgimisë Kulturore, Rregullore (MKRS) 01/2022 për Përcaktimin e Perimetrit dhe Zonës Mbrojtëse të Aseteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Politikave për Konservim dhe Zhvillimin e Tyre, si dhe duke u bazuar në Procedurën Standarde të Operimit (PSO) për aplikimin, përmbajtjen e dosjes së aplikimit dhe procedurave të shqyrtimit dhe miratimit apo refuzimit të kërkesave dhe projekteve konservuese-restauruese në Trashëgiminë Kulturore Arkitekturore nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren dhe në Trashëgiminë Kulturore Arkeologjike nga Instituti i Kosovës dhe duke u bazuar në Rekomandimin e Komisionit Profesional Shqyrtues për Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Konservuese Restauruese të Trashëgimisë Kulturore-Arkeologjike (KPSH) të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për Ndërtimin e Parkingut Nëntoksor pranë Objektivit të Komunes në parcelën kadastrale P-70917048-01355-0 me investitor Kuvendi Komunal Kaçanik, perkatesisht Drejtoria për Administratë Publike.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Profesional Shqyrtues për Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Konservuese Restauruese të Trashëgimisë Kulturore Arkitekturore – IKMM në takimin e 63 të mbajtur më datën 12.10.2023. me kërkesë të QRTK-Ferizaj Ndërtimin e Parkingut Nëntoksor pranë Objektivit të Komunes në parcelën kadastrale P-70917048-01355-0 me investitor Kuvendi Komunal Kaçanik, perkatesisht Drejtoria për Administratë Publike. Pas prezantimit të lëndës nga përfaqësuesi i QRTK- Ferizaj i cili njoftoi KPSH/IKMM se QRTK- Ferizaj më 11.10.2023 me Nr. Pr. 63/2023 ka parashtruar në IKMM kërkesën nga Drejtoria për Administratë Publike, Komuna Kaçanikut për shqyrtimin e lëndës "Ndërtimin e Parkingut Nëntoksor pranë Objektivit të Komunes në parcelën kadastrale P-70917048-01355-0, parcelë kjo e cila gjendet në afërsi të Ndërtesës së Trashëgimisë Kulturore Xhamia e Sinan Pashës, monument ky me Status të Mbrojtjes së Përkohshme i regjistruar në Bazën e të Dhënave të Trashëgimisë Kulturore me Nr.Unik 003172.


Komisioni Profesional Shqyrtues/IKMM, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, rreferuar edhe raporteve të ekipeve profesionale të Institucioneve kompetente për Trashëgimi Kulturore (Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve) në përbërje të plotë, refuzoi kërkesën për ndërtimin e Ndërtimin e Parkingut Nëntoksor pranë Objektivit të Komunes në parcelën kadastrale P-70917048-01355-0, meqenese lokacioni i ndërtimit ndodhet në afërsi të asetit të Trashëgimisë Kulturore Xhamia e Sinan Pashes dhe në të cilin lokacion qendrojnë të hapura strukturat arkeologjike, trajtimi i se cilave është në proces nga Institucioni Kompetent i Trashëgimisë Arkeologjike (Instituti Arkeologjik i Kosovës).

Me sa u tha më lartë dhe bazuar në rekomandimin e Komisioni Profesional Shqyrtues për Kërkesat dhe Projektet Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore Arkitekturore- IKMM, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat kohor prej 30 ditësh, nga data e dorëzimit në Komisionin për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (gjegjësisht Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese - Konservuese të Trashëgimisë Kulturore -Arkitekturore) sipas dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031, për procedurën e përgjithshme administrative.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MKRS;
- Departamentit për Trashëgimi Kulturore;
- Inspektoratit për TK/MKRS;
- QRTK-së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Arkivit të MKRS-së
- Arkivit të IKMM-së
- Palës.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01-Nr. 400/61-27193 /23
Kaçanik; 17.10.2023

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit nr.(Nr.08/L-066) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, te nenit 61 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, propozon KPF-së, këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR TRANSFERIN E MJETEVE

1.Transferet e mjeteve nga kategoria e Shpenzimeve Komunale (fondi 10):

Nga nën-programi:

Infrastruktura rrugore, shuma prej 10,000.00€

2.Transferet e mjeteve nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve (fondi 10):

Nga nën-programi:

Infrastruktura rrugore, shuma prej 8,500.00€

Të transferohen në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime (fondi 10):

Në nën programin:

Infrastruktura rrugore, shuma prej 18,500.00€

Arsyetim: Transferi i ketyre mjeteve kerkohet pershkak të parashikimit të teprikes se mjeteve deri ne përfundim te këtij viti te kategoria e shpenzimeve komunale ku kemi planifikim me te lartë se sa ecuria e shpenzimeve të energjisë elektrike, ujit dhe mbeturinave, poashtu edhe te kategoria e subvencioneve dhe transfereve kemi nënshpenzim të mjeteve te planifikuara për rastet mortore dhe shuma e parashikuar që mbesin të pashpenzara deri ne fund te vitit, kërkohet të transferohen ne kategorinë e mallrave dhe shërbimeve me qëllim të mbulimit të obligimeve kontraktuale në këtë kategori ekonomike.

2.Pjesë përbërëse e këtij Propozim-Vendimi janë Formularet standard nga MFPT. të plotesuara me shumat e lëvizura sipas Nën-Programeve buxhetore dhe kodeve ekonomike te shpenzimeve.

3.Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

Kryetari i Komunës:
Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

DATA:	17.10.2023
REFERENCA:	01-104/02-8220/23
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës së Kaçanikut
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut
NGA/OD/FROM:	Z.Qamil Stagova, Drejtor i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimvendim

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Kaçanikut duke u bazuar në Ligjin për Vetqeverisjen Lokale 03/L-040, neni 17, në bazë të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Neni 5, pika 1.2 dhe Neni 6, pika 1.1, Nenin 14, 15, Statutin e komunës së Kaçanikut, neni 6, pas shqyrtimit të kërkesës së KEDS-it me numër 01-104/02-8220/23, të datës 06.04.2023, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, nëpërmjet Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit i propozon Kuvendit të Komunës që të merr këtë:

VENDIM

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i jep në shfrytëzim afatshkurtër, për një periudhë 15 vjeçare, pronën komunale Kompanisë së Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS), për vendosjen e trafostacioneve.

Vendimi përfshin dhënie e 7 (shtatë) lokacioneve për vendosjen e trafove si në vijim:

1. Projekti "Malësi" (Malzez) –TS i Ri
 - Vendosja e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni 10 (20)/ 0.4kV me fuqi 250kVA, në hapësirën me sipërfaqe 9m², në kuadër të parcelës Nr. 00663-0, Z.K. Rekë (pronë shoqërore- rrugë).

2. Projekti “Çardak 3 (Shyqeri Vishi) “
 - Zhvendosja e trafostacionit ekzistues “Çardak 3 (Shyqeri Vishi)” të tipit shtyllë betoni 10(20)/0.4kV me fuqi 250 kVA në hapësirën me sipërfaqe 9m², në kuadër të parcelës Nr.02150-0, Z.K. Kaçanik i Vjetër, (pronë shoqërore- rrugë).
3. Projekti “Çardak 3 (Shyqeri Vishi) TS i Ri”
 - Vendosja e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni 10(20)/0.4kV me fuqi 100 kVA në hapësirën me sipërfaqe 9m², në kuadër të parcelës Nr.01406-0, Z.K Kaçanik i Vjetër, (pronë shoqërore- rrugë e pakategorizuar).
4. Projekti “Kotlint, Kaçanik i Vjetër”
 - Zhvendosja e trafostacionit ekzistues “Kotlint, Kaçanik i Vjetër” të tipit shtyllë metalike 10(20)/0.4kV me fuqi 250KVA, në hapësirën prej 9m², në kuadër të parcelës Nr.02144-2 Z.K Kaçanik i Vjetër (pronë shoqërore-rrugë).
5. Projekti “Kotlint, Kaçanik i Vjetër TS i Ri”
 - Vendosja e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni 10(20)/0.4kV me fuqi 160kVA në hapësirën me sipërfaqe 9m²- në kuadër të parcelës Nr. 00966-0, Z.K Kaçanik i Vjetër (pronë shoqërore-rrugë).
6. Projekti “Bobi”
 - Vendosja e Stabilimentit shpërndarës të tipit A me dimensione (5200x2200x2600) mm, në hapësirën me sipërfaqe 30m²- në kuadër të parcelës Nr. 00423-0, Z.K Ivajë (pronë e komunës) .
 - Zhvendosja e trafostacionit ekzistues (TS Ivajë e re) të tipit shtyllë betoni 10(20)/0.4kV me fuqi 160kVA, në hapësirën me sipërfaqe 9m²- në kuadër të parcelës Nr.01062-0, Z.K Ivajë (pronë shoqërore- rrugë).

Pozitat e trafostacioneve janë të përcaktuara me koordinatat e 4 pikave.

Arsyetim

Kompania e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS) i është paraqitur komunës së Kaçanikut me kërkesën 01-104/02-8220/23 më 06.04.2023, për dhënien e tokës, pronë e komunës, për vendosjen e trafostacioneve. Gjithsej është kërkuar pronë në 7 lokacione. Drejtoria e Urbanizmit duke shqyrtuar kërkesën e KEDS-it, duke u bazuar në Ligjet në fuqi, me qëllim të modernizimit të rrjetit elektrik në territorin e komunës së Kaçanikut, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Drejtori i DUKMM-së
z.Qamil Stagova



Kryetari i Komunës
z.Besim Hazi



	NJËSIA INVESTIMET	Nr.	KEDS-DIV-F-DIV-02
	KËRKESË PËR SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE	Faqe	Faqe 1 prej 1
		Versioni	1.0

Date:	05.04.2023	28.50	05 APR 2023
Për:	Kryetarin e Komunës së Kaçanik z. Besim Ilazi	Ne	PRISHTINA 1
Emri:	Alpin Dogan, Kryeshefi Ekzekutiv i KEDS Faruk Gjukaj, Drejtori i Departamentit për Investime Burbuqe Baruti, Inxhinierë për Bashkëpunim me Institucione Qeveritare		
Tema:	KËRKESË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SHOQËRORE/KOMUNALE SIPAS LIGJIT Nr.06/L-092 DHE LIGJIT PËR ENERGJI Nr.05/L-081		
Lenda:	Projektet me Plan Investiv 2022 për regionin e Komunës së Kaçanikut		

Në bazë të Planit Investiv 2022 për Zgjerim dhe Përf forcim të Rrjetit Shpërndarës, KEDS ka paraparë të ndërtohen trafostacione 10(20)/0.4kV për regionin e Komunës së Kaçanikut, andaj kërkojmë nga titulli i lartshënuar që të jep lejen e shfrytëzimit të pronës shoqërore/komunale në shfrytëzim për projektet:

1. Projekti "Malësi (Malzez) - TS i Ri"

- Vendosja e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni 10(20)/0.4kV me fuqi 250kVA, në hapësirën prej 9[m²] - në kuadër të parcelës nr.00663-0 ZK Rekë (pronë shoqërore-rrugë).

2. Projekti "Qardak 3 (Shyqeri Vishi)"

- Zhvendosja e trafostacionit ekzistues "Qardak 3 (Shyqeri Vishi)" të tipit shtyllë betoni 10(20)/0.4kV me fuqi 250kVA, në hapësirën prej 9[m²] - në kuadër të parcelës nr.02150-0 ZK Kaçanik i Vjetër (pronë shoqërore-rrugë)

3. Projekti "Qardak 3 (Shyqeri Vishi) - TS i Ri"

- Vendosja e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni 10(20)/0.4kV me fuqi 100kVA, në hapësirën prej 9[m²] - në kuadër të parcelës nr.01406-0 ZK Kaçanik i Vjetër (pronë shoqërore-rrugë e pakategorizuar).

4. Projekti "Kotlinët, Kaçanik i Vjetër"

- Zhvendosja e trafostacionit ekzistues "Kotlinët, Kaçanik i Vjetër" të tipit shtyllë metalike 10(20)/0.4kV me fuqi 250kVA, në hapësirën prej 9[m²] - në kuadër të parcelës nr.02144-2 ZK Kaçanik i Vjetër (pronë shoqërore-rrugë).

5. Projekti "Kotlinët, Kaçanik i Vjetër - TS i Ri"

